

Terma Reference

Ekspert për zhvillimin, koordinimin dhe analizën e anketës (survey) mbi sigurinë dhe mirëqënien digjitale të fëmijëve

1. Informacion mbi organizatën

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është pjesë e një organizate ndërkombëtare që punon për mirëqenien e fëmijëve pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë. Organizata mbështet fëmijët, të rinjtë dhe familjet përmes shërbimeve të integruara në fushat e kujdesit, edukimit, zhvillimit social dhe fuqizimit ekonomik, me qëllim që çdo fëmijë të rritet në një mjedis familjar të sigurt dhe mbështetës.

2. Sfondi

Në kuadër të projektit ndërkombëtar “Ctrl+SAFE: Empowering children, parents, caregivers and digital service providers for a safe and responsible use of digital services”, organizata synon të forcojë sigurinë dhe mirëqenien digjitale të fëmijëve dhe të rinjve.

Si pjesë e aktiviteteve përgatitore për zhvillimin e hackathoneve dhe ndërhyrjeve të mëtejshme, projekti parashikon realizimin e një ankete kombëtare me fëmijë dhe të rinj të moshës 11–18 vjeç, me qëllim kuptimin më të thelluar të përvojave të tyre në lidhje me sigurinë dhe mirëqenien në mjedisin online.

3. Qëllimi i angazhimit

Qëllimi i këtij angazhimi është sigurimi i një procesi cilësor, etik dhe gjithëpërfshirës për zbatimin e anketës, duke përfshirë mbështetje teknike në koordinim, mbledhje të dhënash dhe analizë të rezultateve në nivel kombëtar.

4. Objektivat specifike

Eksperti do të mbështesë projektin për të:

- Siguruar zbatimin korrekt të anketës sipas udhëzuesit të projektit
- Garantuar përfshirjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël
- Siguruar respektimin e standardeve etike dhe të mbrojtjes së të dhënave
- Analizuar të dhënat dhe përgatitur një raport analitik me gjetje dhe rekomandime

5. Detyrat dhe përgjegjësitë

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

a) Përgatitja dhe koordinimi

- Përshtatjen e metodologjisë së anketës në kontekstin lokal
- Hartimin e planit të zbatimit (kalendari, targetet, metodologjia)



- Koordinimin me stafin e projektit për organizimin e procesit

b) Mbledhja e të dhënave

- Mbështetjen e ekipit për përfshirjen e minimumi 50 fëmijëve pjesëmarrës (kryesisht në Shkodër dhe Tiranë)
- Sigurimin që procesi të jetë i sigurt, gjithëpërfshirës dhe i aksesueshëm
- Mbikëqyrjen e zhvillimit të anketës (online ose fizikisht)

c) Aspekte etike dhe mbrojtja e të dhënave

- Respektimin e parimit të interesit më të mirë të fëmijës
- Garantimin e anonimitetit dhe konfidencialitetit
- Zbatimin e “informed assent” dhe, kur është e nevojshme, pëlqimit prindëror
- Përputhshmërinë me standardet e mbrojtjes së të dhënave (GDPR)

d) Analiza dhe raportimi

- Përpunimin e të dhënave në formatin e kërkuar
- Analizën cilësore dhe sasiore
- Hartimin e raportit përfundimtar me gjetje, trende dhe rekomandime

6. Zona e zbatimit dhe aspektet logjistike

Angazhimi i ekspertit parashikohet të zhvillohet në Shkodër dhe Tiranë.

Të gjitha kostot që lidhen me transportin, akomodimin apo shpenzime të tjera logjistike duhet të mbulohen nga eksperti.

7. Produktet e pritshme

- Plan pune për implementimin e anketës
- Mbështetje në procesin e mbledhjes së të dhënave
- Dataset i përpunuar sipas formatit të projektit
- Raport analitik përfundimtar (max. 12 faqe)

8. Kohëzgjatja e angazhimit

Angazhimi do të zgjasë nga momenti i kontraktimit deri më 23 Qershor 2026.

9. Kualifikimet dhe eksperiencia e kërkuar

- Diplomë universitare në shkencë sociale, psikologji, edukim ose fusha të ngjashme
- Eksperiencë në kërkime sociale dhe analiza të të dhënave
- Përvojë pune me fëmijë dhe grupe vulnerabël
- Njohuri mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe standardet etike
- Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave (GDPR)
- Aftësi të mira analitike dhe raportimi

10. Raportimi dhe mbikëqyrja



Eksperti do të raportojë tek Koordinatori i Projektit dhe do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit në nivel lokal dhe kombëtar.

11. Aplikimi

Të interesuarit ftohen të dorëzojnë:

- CV të përditësuar
- Letër interesi (max. 1 faqe)
- Plan pune / metodologjie (max. 1 faqe)
- Një ofertë financiare (bruto) për realizimin e shërbimit. Nga kjo shumë bruto do të mbahen dhe paguhet detyrimet në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Aplikimet duhet të dërgohen në: info@soskd.org.al
Subjekti: *Ctrl+SAFE aplikim Anketa*
Afati I aplikimit: **13 Maj 2026**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

12. Dispozita të përgjithshme

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e ekspertit dhe paraqitjen e ofertës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.